



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 12-060/01-13853 dt. 13-03 2020

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z. Labinot Halilaj, me dt: 20.03.2020 (e premte) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET

Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 21.02.2020.
2. Propozim Vendim i statutit për ndërmarrjen publike Lokale "Stacioni i autobusëve", SH. A. në Drenas-Glogoc.
3. Propozim Vendim për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmben dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen në parcelën 743/1, në zonën e kadastrave Drenas.
4. Të ndryshme.

Drenas, 13. 03 .2020



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr. 060/01-11844 dt. 03/03/ 2020

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 21.02.2020, ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi z. Gani Podrimqaku- Anetari i K.P.F-ca.

Në mungesë të kryesuesit z. Gani Podrimqaku deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Gani Podrimqaku, Blerina Gashi, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi si dhe Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci, Nënkryetari i Komunës z. Nazmi Hasi, përfaqësues të OSBE-së.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

- 1.Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 24.01.2020.
- 2.Propozim Vendim për miratimin e Propozimit Profesional për Shpalljen e Lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) në pjesën e Komunës së Glllogocit.
- 3.Rregullore për Organizimin e Punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit.
- 4.Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2019.
- 5.Propozim vendim për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së Drenas. .
- 7.Të ndryshme.

Z. Podrimqaku deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci- njoftoi se me dt. 27/02/2020 (e enjte) në ora 17:00 do të ketë debat me temë: Politika Komunale (lokale) në Komunën e Drenasit, me anëtarët e delegacionit si : z. Rainer Wieland, Zëdhënës Presidenti Evropian – qytetar Nderi Në Komunën e Drenasit. Si doni e mbajmë seance të veçante apo si pikë e rendit të ditës në mbledhje.

Burim Bujupi- do të ishte mirë me e lënë si pikë të veçantë sepse ne nuk e dina sa mund të zgjasë seanca, si seancë e veçantë do të ishte me mirë me qenë.

Të gjithë u pajtuan që të mbahet si takim i veçantë me z. Rainer Wieland.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- e ceku se mund me vijë edhe një kërkesë për ndërtimin e disa shtatoreve në Drenas.

z. Gani Podrimqaku, hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar:

Për votuan 06 anëtar, kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

z. Gani Podrimqaku- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1.Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 24.01.2020.**

Burim Bujupi- e kemi pas si pikë e rendit të ditës rregullore për Organizimin e Punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit, materiali ka ardh sot, si ka mundësi me qenë pika ndërsa materiali jo ku është problemi?

z. Gani Podrimqaku- arsyeja e vonësës se rregullores është se komisioni u dashtë me punu më shumë në rregullore dhe kanë dal disa probleme gjatë hartimit të rregullores, dhe më mirë si është vonu dhe janë përmirësuar disa gabime teknike që kanë qenë, se sa me ardh një rregullore në komitet e pa pranueshme që është dashtë me kthye edhe një herë mbrapa.

Burim Bujupi- të falënderoj për sqarimin, por në momentin që nuk e kemi ne materialin atëherë nuk kemi ne as çka me diskutu rreth asaj pike sepse pa material nuk e dimë se çka të diskutojmë.

Florentina Elezi- pasi që u hap kjo temë materiali i rregullores është vonuar dhe arsyetimi po me duket jo i kapshëm, dhe ne jemi asambleista dhe kemi të drejt me pas materialin fizikisht me kohë, tani sa e mora rregulloren po e shikoj që nuk e kemi një raport të komisionit gjë që është shumë e nevojshme, dhe besoj që në mbledhje të kuvendit apo edhe tani nëse e kanë të gatshme me na sjellë, unë si asambleiste nuk e di si ka rrjedhë puna e komisionit, sa mbledhje kanë mbajt dhe si, kërkoj tani që nëse e kanë raportin e gatshëm me na sjellë, si kanë rrjedhë punët sa takime kanë mbajt me kë kanë bashkëpunuar etj.

Kryetari i Komunës z. Ramiz Lladrovci- draft rregulloren e ka përgatit bashkëpunëtori i komunës sonë zv. Ministri i tashëm i Qeverisë së Kosovës z. Jusuf Thaqi, ka disa ndryshime, propozime për të cilat jemi vonuar sepse komisioni mësuesja dhe znj. Xhylani kanë provuar me e fut në test pika të cilat bien në ndesh me kushtetutën dhe unë nuk kam lejuar, prandaj gjithçka që do të jetë në këtë draft rregullore e cila do të diskutohet gjatë edhe në kuvend do të jetë në konform ligjeve dhe rregulloreve, rregullorja është vonuar për arsye se ka qenë edhe debate publike, e keni për obligim edhe ju si asambleista me marrë pjesë, jemi radhit si komuna e tretë për performancë si rezultat i mos pjesëmarrjes së asambleistave në debate publike, për projekt qarkoren buxhetore nga asambleistat.

Florentina Elezi- pikërisht për këtë arsye kam dëgjuar dhe kam qenë debat publik dhe e kam shikuar se ka nene të cilat e shkelin ligjin, fatmirësisht e shikova se disa prej tyre vetëm qenkan rregulluar, për këtë arsye kërkova raport që herën tjetër kur të votojmë një komision me ditë kanë po e votojmë.

Burim Bujupi- a ka qenë e nevojshme që kjo rregullore me ardh sot në komitet pa e pas ne materialin, a keni mundur me e shty për seancën e ardhshme?

Nënkryetari i Komunës z. Nazmi Hasi- objekti i kësaj rregullore është funksionimi sa më efikas i procesit edukativo-arsimor, mirëpo sa ma shpejt që me e shqyrtu këtë rregullore është e domosdoshme për shkak se pas kësaj rregullore do të pasojnë edhe rregulloret në nivel të shkollës që i specifikojnë procedurat përgjithësitë dhe obligimet të secilit faktor relevant në shkollë, prandaj duhet sa ma shpejt në mënyrë që në shtator vitin e ri shkollorë të startojë me të gjitha rregulloret edhe të nivelit qendror edhe të nivelit të shkollës.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka-ato që u thanë edhe u sqaruan vetëm desha për Burimin ne e kemi llogarit për me e shti si pikë të rendit të ditës në bazë të procedurave mirëpo pas dëgjimit publik, ka qenë një dëgjim publik që kemi marrë rekomandime dhe ato i kemi pas parasysh dhe komisioni ka punuar dhe ka marrë kohë që ato të inkorporohen dhe derisa të finalizohet dhe kjo rregullore, ju e keni pranuar me vonesë gjë që kërkojmë falje, por nuk ka pas ndonjë arsye tjetër, është e domosdoshme një rregullore sepse i rregullon shumë çështje edhe pse i kemi pas udhëzimet administrative, sigurisht që edhe komisionit do ta bëjë edhe një raport përfundimtar por besoj që baza ligjore është e cekur edhe ne fillim që me pas ma te lehtë ku jemi bazu dhe i kemi marrë për bazë edhe rregulloret tjera mirëpo rregulloret tjera kanë qene të viteve paraprake dhe kanë ndryshuar udhëzimet administrative dhe konsiderojmë se është një rregullore e kompletuar çdo herë do të këtë mundësi për ndryshime, dhe secila shkollë është e obliguar me pas një rregullore të brendshme, po ju siguroj që kjo rregullore është bazuar në udhëzime administrative, legjislationit, kushtetutën.

Burim Bujupi- meqenëse ende nuk kemi arrit të kjo pikë e rendit të ditës mirëpo e shterrem debatin.

Florentina Elezi- meqë folëm për rregullore po e përfundojmë këtë pikë pastaj vazhdojmë me të tjerat.

Edolina Plakiqi- kam informacion se drejtori i ri i gjimnazit në shkollën e mesme në gjimnaz po u mbajtke edhe ora e shtatë e cila po përfundojë në ora 6:20 min, si mund ta bëni një zgjidhje për transport që mos me u nis në të kohë për me e ndryshu orarin ose mos me mbajt orën e shtatë fare.

Drejtori i Arsimit Muhamet Gjoka- është e vërtetë që pas ardhjes se pozitës së drejtorit në gjimnaz ai e ka vërejtur se ora shtatë nuk po mbahet dhe duhet të mbahet që ne jemi pajtuar plotësisht që ora shtatë më u majtë, kemi kërkuar që të shikohet orari që a ka mundësi me e zhvendos orën e shtatë, ne kemi kontaktuar edhe me drejtorinë e shërbimeve publike që me na asistë në përpilim të orarit të autobusëve, I kemi angazhuar edhe inspektorët sepse ata veç e kanë orarin mirëpo nuk po e respektojnë dhe fatkeqësisht kane mbet disa nxënës pa transport që u dashtë me e siguruar disa forma tjera transportin, për këtë e kemi njoftuar dhe drejtorinë e shërbimeve publike mirëpo edhe inspektoratin që kanë marrë masa dhe besoj që kjo nuk do të përsëritet më sepse orari është, tani e tutje nuk është arsye me orari I autobusëve besoj se ata do t'ju përmbahen sepse ju evokohet licenca.

Pasi nuk pati diskutime tjera, **z. Podrimqaku** hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës:

1.Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 24.01.2020, ku të pranishëm gjatë votimit ishin 6 anëtar:

Për votuan 6 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Pas diskutimeve të pikës së tretë (3) për **Draft Rregullore për Organizimin e Punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit**, edhe këtë pikë të rendit të ditës hodhi në votim, e cila në mënyrë anonimë u votua që të kalon për kuvend më 6 vota për, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

z.Podrimqaku hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **Propozim Vendim për miratimin e Propozimit Profesional për Shpalljen e Lokalitetit të Boshtërës (Forsythia europaea) në Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) në pjesën e Komunës së Glllogocit.**

Drejtoresha për Planifikim Hapsinor Flutura Avdiu- njoftoi se për hartimin e arsyeshmërisë profesionale për shpalljen e lokalitetit të Boshtërës (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës, Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me vendimin Nr.7519.18 të datës 17.12.2019, ka formuar Grupin punues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, në këtë përbërje:

Qenan Maxhuni, IKMN- kryesues

Valmira Gashi, DMMU- anëtar

Elez Krasniqi, Prof Asoc. Dr. Departamenti i Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- anëtar

Adnan Bullatovci, Komuna Fushë Kosovë- anëtar

Bajram Sinani, Komuna Lipjan- anëtar

Haki Bekolli, Komuna Glogoc- anëtar

Përparim Gashi, SIM- anëtar

Pas hartimit të propozimit profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës nga grupi punues i formuar sipas vendimit Nr.7519/18 të datës 17.12.2019, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, me Propozimin 08-Nr.03070788 dt. 13.12.2019, duke u bazuar në Vendimin e Agjencisë për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës të MMPH-së me nr.7518/18 të datës 19.12.2018, për Hartimin e arsyeshmërisë profesionale për Shpalljen e lokalitetit të boshtres (Forsythia europiana) Golesh si monument i mbrojtur i natyrës të paraqitur të Kryetari i Komunës, është kërkuar të merret vendim për lejimin e hapjes së konsultimit publik për Propozimin Profesional për Shpalljen e lokalitetit të boshtres (Forsythia europiana) Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime në Sankoc, në pjesën e komunës së Glogocit të punuar nga grupi punues sipas vendimit të lartëshënuar.

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit 08-Nr.030-70789 dt. 13.12.2019, paraqitur nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr.28/2008), nenin 72 të Statutit të Komunës së Glogocit 01-Nr.110-6904 dt. 24.09.2008, ka marrë Vendim me të cilin Lejohet fillimi i procedurave për hapjen e konsultimit publik për Propozimin profesional për shpalljen e lokalitetit Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh, pjesë e fshatit Sankoc, Komuna e Glogocit- "Zonë e Mbrojtur në Kategorinë e Monumentit të Natyrës". Në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Glogocit 01-Nr.070-71395 të datës 17.12.2019, për lejimin e hapjes së konsultimit publik për Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) në pjesën e Komunës së Glogocit të punuar nga grupi punues, është publikuar Njoftimi për Shpallje Publike në të cilën janë ftuar dhe njoftuar qytetarët për të shprehur mendimet për Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia Europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës duke ndihmuar në dhënien e mendimeve, sugjerimeve, komenteve e vërejtjeve për këtë propozim dokument në afat prej 30 ditësh nga dita e hapjes së konsultimit publik.

Burim Bujupi- kërkoj sqarim rreth kësaj bime, cila është dobia e saj, dhe qka shohim në të për arsye se po merret një zonë e madhe që i bien përafërsisht 100 h?

Drejtoresha për Planifikim Hapësinor Flutura Avdiu-raportin, arsyeshmërinë profesionale besoj se në kuvend do të shqyrtohet edhe një herë dhe do të behet një arsyeshmëri e saktë e dobisë edhe e rëndësisë të kësaj bime dmth kjo bimë është kryesisht e natyrës biologjike kemi pas një debat rreth hapësirës sepse me të vërtetë është një hapësirë e madhe.

z. Podrimqaku hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin anëtar: për votuan 6 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Meqë pika e tretë u diskutua dhe u votua **z. Gani Podrimqaku** hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4.Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2019.**

Pasi që nuk pati diskutime për këtë pikë të rendit të ditës të gjithë anëtarët e Komitetit për Politike dhe Financa rekomanduan që edhe kjo pikë e rendi të ditës të kalon për kuvend.

z. Podrimqaku- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës :**5.Propozim vendim për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së Drenas.**

Pasi që nuk pati diskutime për këtë pikë të rendit të ditës të gjithë anëtarët e Komitetit për Politike dhe Financa rekomanduan që edhe kjo pikë e rendi të ditës të kalon për kuvend.

z.Gani Podrimqaku – hapi diskutimin edhe për pikën e fundit të ndryshme.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime z. Podrimqaku e konsideroj e seancën e mbyllur.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11:00 min

Procesmbajtëse



Zahrie Podrimqaku-Subashi



Kryesuesi I Kuvendit Komunal



Labinot Halilaj



Republik e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Glogocit
Opstina Glogovac
Municipality of Glogoc
Zyra e Krvetarit

Datë: 12/03/2020

<http://kk.rks-gov.net/glogoc/>

PROPOZIM VENDIM

STATUTI

PËR

NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE “STACIONI I AUTOBUSAVE ”

SH.A. NË GLLOGOC

MARS / 2020

Mbështetur në nenin 34 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" 9/2018, 24 maj 2018), të dispozitave të nenit 4, paragrafët 4.1 dhe 4.2 të Ligjit Nr.03/L-087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 1/2008, 15 qershor 2008). Ligji Nr. 05/L -009 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar më ligjin 04/l-111 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" 10/2015, 07 maj 2015, neni 12 paragrafi 1, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008, 04 qershor 2008), neni 72, pika 72.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Gllogocit të miraton këtë:

STATUTI

PËR

NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSAVE "

SH.A. NË GLLOGOC

1. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Me këtë Statut rregullohen parimet themelore si, emërtimi, selia, veprimtaria e Ndërmarrjes Publike Lokale " Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Gllogoc, statusi juridik, përfaqësimi-prezantimi, strukturat dhe trupat organizative të institucionit public, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, aktet e përgjithshme, pronësia dhe financimi, transparenca, konfidenca afariste dhe profesionale, mbikëqyrja e brendshme, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së Ndërmarrjes Publike Lokale"Stacioni i Autobusëve " SH.A. në Gllogoc (në tekstin e mëtejme: "Statcioni i Autobusëve" SH.A. Gllogoc).

2.Ndërmarrja publike lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Gllogoc, ka statusin e ndërmarrjes publike lokale, e cila mund të paditet dhe të padisë, të posedojë të udhëheq dhe t'i përcaktojë kushtet e udhëheqjes dhe shfrytëzimit të pasurisë së saj, të lidhë kontrata, të punësoj dhe të largojë punonjës nga ndërmarrja dhe të angazhohet në aktivitete të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së saj nëse nuk është e rregulluar ndryshe me ligj dhe akte nënligjore.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc, ka hapsirë për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve sipas rendit të udhëtimit, hyrjen dhe zbritjen e udhëtarëve, shitjen dhe rezervimin e biletave për udhëtarë, gardërobën, paisjen për informimin e udhëtarëve dhe operatorëve të transportit, si dhe shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorët transportues.
2. Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc është i obliguar që të mbajë evidence për hyrjen dhe daljen e autobusëve të sektorit publik dhe të sektorit privat.
3. Me fuqizimin e rendit të udhëtimit, Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc është i obliguar të bëjë sistematizimin e rendit të udhëtimeve sipas realicioneve dhe kohën e nisjes së autobusëve nga sistemi.
4. Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Glllogoc në kushte të barabarta, t’u ofron shërbime të gjithë opratorëve transportues, të cilët e kanë rendin e udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar në Komunën e Glllogocit, sipas tarifës së përcaktuar nga Komuna e Glllogocit, bazuar në kategorinë e stacionit të autobusëve.
5. Ndërmarrja mund të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direct apo indirect me objektin e saj, Brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
6. Ndërmarrja dë të kryejë çdo veprim, me qëllim të marrjes së lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprmtarisë së saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

Neni 3

Selia qendrore

1. Selia kryesore Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. , Rr.”Ilaz Kodra” pa.nr. në Glllogoc.
2. Shenja njohëse (emblema) e NPL-së do të dizajnohet nga Bordi i Drejtorëve i ndërmarrjes dhe do të miratohet nga ky Bord i Drejtorëve.
3. Emërtimi i NPL-së duhet të jetë i mbishkruar në objektin kryesor të NPL-së në të cilën kryhet veprimtaria publike dhe atë në gjuhët zyrtare në përdorim në Republikën e Kosovës.
4. Për ndryshimin e emrit dhe selisë së NPL-së, vendosë thmeluesi.

Neni 4

Përfaqësitë e Ndërmarrjes-shoqërisë aksionare

Ndërmarrja/shoqëria aksionare, sipas këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, mund të hapë: qendra, përfaqësi apo degë duke zhvilluar aktivitetin e vet branda Komunës së Glllogocit.

Neni 5

Kohëzgjatja

- 1.Kohëzgjatja e ndërmarrjes publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Gllogoc si shoqëri aksionare, është e pakufizuar, përveç nëse vendoset ndryshe me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe aktet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- 2.Nëse kohëzgjatja e ndërmarrjes ndryshohet. Për këtë duhet të njoftohet Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Republikën e Kosovës dhe të kërkohet që kjo të publikohet nga ana e Agjencisë në bazën e të dhënave të saj.

Neni 6

Themeluesi i Ndërmarrjes

- 1.Komuna e Gllogocit është pronare e ndërmarrjes, me aksione 100% në pronësinë e saj.
2. Ndërmarrja publike lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Gllogoc, është trashëgimtare e ndërmarrjes shoqërore N.P.T.SH. “KosovaTrans” në Gllogoc.
- 3.”Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Gllogoc, themelohet pas regjistrimit të Statutit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Republikën e Kosovës, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” 9/2018, 24 maj 2018).

Neni 7

Statuti dhe Rregulloret

- 1.Ndërmarrja themelohet vetëm pas regjistrimit të këtij Statuti në Zyrën e Regjistrimit të Biznesit. Ky Statut është dokumenti themelues dhe konstituiv i Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” në Gllogoc. Ndryshimet dhe Plotësimet në statut, nuk kanë efekt juridik derisa të miratohen nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Gllogoc dhe nga Kuvendi Komunal i Gllogocit dhe të dorëzohen në Zyrën e Regjistrimit të Biznesit në përputhje me dispozitat ligjore.
- 2.Ndërmarrja, obligohet të nxjerrë rregulloret të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e saj, Rregulloret miratohen, ndryshohen ose revokohen nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” në Gllogoc.

Neni 8

Përgjegjësitë

- 1.Komisioni komunal i Aksionareve, Bordi i drejtorëve dhe stafi i “Stacionit të Autobusëve” SH.A. në Gllogoc, është përgjegjëse për pasurinë që e gëzon ajo, të drejtat dhe detyrimet që vijnë si rezultat i këtij transformimi.
- 2.Asnjë person, shoqëri tregtare ose shoqëri tjetër, nuk është përgjegjëse për detyrimet e shoqërisë aksionare vetëm për shkak se është kontraktues në këtë shoqëri.

Neni 9
Mbikëqyrja Administrative dhe Menaxheriale

Ndërmarrja Publike Lokale “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Gllogoc mbikëqyret nga Bordi i Drejtorëve dhe menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Neni 10
Përgjegjësitë e themeluesëve për veprimet para regjistrimit

Nëse janë ndërmarrë veprime në emër të ish-ndërmarrjes para regjistrimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në hapjen e xhirologarive bankare, blerjen dhe dhënien me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve të tjera, pasi Shoqëria të jetë regjistruar, ajo e merr përsipër përgjegjësinë për këto detyrime dhe raste të tilla, “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Gllogoc. Është e vetmja pale përgjegjëse për pretendimet dhe detyrimet.

Neni 11
Shpallja e tarifave

1.Statuti, aktet normative të ndërmarrjes dhe tarifat për dhënien e shërbimeve të N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Gllogoc publikohen në tabelën e publikimit të ndërmarrjes.

22.Ndërmarrja me rastin e aprovimit të tarifave të reja është e obliguar të njoftoj shfrytëzuesit nëpër mes shpalljeve në tabelën e shpalljeve të ndërmarrjes, në ndënjë vend adekuat në “Stacion të Autobusëve” dhe nëse ka mundësi finaciare edhe nëpërmes të informimit publik.

Neni 12
Kapitali

Kapitali themeltar i ndërmarrjes përbehet nga pasuaria e luajtshme dhe e paluajtshme. Aksionari i vetëm i ndërmarrjes është Komuna e Gllogocit. Të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar, bëhen sipas përcaktimit në ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, ku përfshihet shuma, parapagimi, rritja e kapitalit themeltar, zvogëlimi i kapitalit themeltar, etj.

Neni 13
Mbledhja e Aksionarëve

1.Mbledhja e aksionarëve të “Stacioni i Autobusëve” SH.A. në Gllogoc, është organi më i lartë vendimmarrës i ndërmarrjes publike lokale.

2.Vendimet e mbledhjes së aksionarëve janë detyruese për ndërmarrjen, Bordin e Drejtorëve të ndërmarrjes, si dhe për zyrtarët e ndërmarrjes.

3.Thirrja dhe rendi i ditës së mbledhjes, njoftimi i mbledhjes dhe procedimet, kourumi për mbledhje, udhëheqësi i mbledhjes, votat e aksionarëve dhe kompetencat e mbledhjes do të rregullohen me akte të veçanta, në pajtim me nenin 130 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" 9/2018, 24 maj 2018).

Neni 14 **Bordi i Drejtorëve**

1.Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. do të përbëhet nga pesë (5) drejtor.
2.Katër (4) drejtor zgjidhen në një mbledhje të Komisionit Komunal të Aksionarëve në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" 9/2018, 24 maj 2018). Mandati i tyre është prej 3 viteve. Komisioni Komunal i Aksionarëve e përfaqëson Komunën në këtë mbledhje dhe i ushtron të drejtat e votimit të komunës në përputhje me këtë ligj. Drejtori tjetër është Kryeshefi Ekzekutiv (KE) i Ndërmarrjes Publike I cili zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike në përputhje me nenin 21 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

3.Bordi i Drejtorëve është organ i pavarur edhe nga dërmarrja.

4.Menaxheri ose Zyrtari i Ndërmarrjes nuk mund të jetë Antëtar I Bordit të Drejtorëve.

Neni 15 **Funksionimi i Bordit të Drejtorëve**

Kompetencat dhe përgjegjësit e ndërmarrjes publike locale, "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Glllogoc, do të ushtrohen nga Bordi i Drejtorëve, ashtu siç është përcaktuar me ligj, statutin e "Stacionit të Autobusëve" SH.A. në Glllogoc dhe nga aktet të cilat vetë i ka miratuar.

Neni 16 **Përgjegjësit dhe detyrat e Bordit të Drejtorëve**

1.Të respektojë ligjet, statutin e ndërmarrjes, aktet e tjera dhe të zbatojë vendimet e Komisionit Komunal të Aksionarëve, në pajtushmëri me ligjin.

2.Të përcaktojë, dhe së paku çdo 3 (tre) muaj të rishikoj strategjinë e ndërmarrjes.

3.Të përgatisë dhe të miratojë strategjinë afatmesme apo afatgjatë, investimet dhe planet financiare të ndërmarrjes dhe brenda afatit relevant kohor, të rishikojë atë kurdo që është e nevojshme, së paku në çdo 3 (tre) muaj të bëjë ndryshime, të cilat mund të jenë të nevojshme.

4.Të miratojë planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor, të përgaditur nga Kryeshefi Ekzekutiv, në bazë të planit afatmesëm apo afatgjatë.

5.Të emëroj, largojë apo zëvendësojë Kryshefin Ekzekutiv, të përcaktojë me propozim të Komisionit të auditimit kompensimin e tij ose saj, dhe të sigurojë që procesi për përzgjedhjen e

KE-së do të organizohet në mënyrë transparente dhe të arsyeshme, në këtë mënyrë t'i sigurojë shoqërisë disponueshmërinë e talenteve dhe kompetencave adekuate.

6.Të përcaktoj rastet, përkatësisht çështjet dhe transaksionet, të cilat nuk janë në kompetence të KE-së, përkatësisht ka fuqi të kufizuar për të vepruar në mënyrë të pavarur në kuptim të dispozitave të nenit 192 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

7.Të emërojë dhe largojë ZKFTH dhe sekretarin e përgjithshëm, dhe në bazë të propozimit të Komisionit të auditimit të përcaktojë kompensimin e tyre.

8.Të përcaktojë, me propozim të KE-së, transaksionet financiare, në bazë të të cilave KE-ja nuk do të ketë fuqinë të veprorë (dhe të obligojë ndërmarrjen) në mënyrë të pavarur, dhe do të duhej të kërkojë autorizim paraprak nga KE-ja, apo nga Bordi i Drejtorëve.

9.Të kryejë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigorozë mbi punën e biznesit të ndërmarrjes mbi punën e KE-së, ZKFTH-së dhe sekretarit të përgjithshëm, mbi organizimin e brendshëm të ndërmarrjes dhe bi performance e ndërmarrjes, dhe të sigurojë se linjat e raportimit të ndërmarrjes janë të organizuar për të lejuar performance dhe mbi këto baza, të zbatojë këto detyra të besuara të zyrtarëve (në rastin e zyrtarit të auditimit të brendshëm, vetëm me propozim të Komisionit të Auditimit).

10.Të miratojë në fund të secilit vit të biznesit, pa kurrfarë vonese dhe në çfarëdo rasti brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas përfundimit të vitit financiar të ndërmarrjes.

11.Bilancin vjetor dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjeve të ndërmarrjes, dhe çfarëdo pasqyre tjetër financiare që kërkohet me ligj.

12.Raportin vjetor të menaxhimit, rregulloret e biznesit, gjendjen financiare të ndërmarrjes do të duhet të përfshijë vështrimet, në atë mënyrë që performance e ndërmarrjes të mund të barazohej me planet afatmesme apo afatgjata dhe të paraqesë propozimin e saj për alokim, investim apo shpërndarje të fitimit vjetor, apo mulimin e humbjeve.

13.Deklaratën për aksionarët që sipas njohurive më të mira të Bordit të Drejtorëve, duke marrë parasysh raportin e Komisionit të auditimit dhe sipas hetimit të vetë të pavarur dhe të kujdeshëm dhe konsolidimit adekuat, dokumentet e lartpërmendura janë të vërteta, të drejta dhe të sakta, dhe ato nuk lënë pa përmendur asnjë informatë apo pasqyrë e që mos përfshirja e tyre do të konsiderohej si lajthitje, dhe ato t'i dorëzojë, së bashku me raportin nga Auditori i Jashtëm në dokumentet e parashtruara tek aksionarët së paku tridhjetë (30) ditë para dates së mbledhjes së Komisionit Komunal të Aksionarëve.

14.Të sigurojë që sistemet adekuate të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë kontrollin financiar dhe procedurat dhe proceduar janë në vendin e duhur.

15.Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë në vendin e duhur për të garantuar se librat dhe regjistrat e ndërmarrjes, duke përfshirë regjistrat financiarë, mbahen në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit dhe ligjeve në fuqi, dhe propozim raportet financiare vjetore janë të përgatitura si duhet.

16.Të sigurojë se auditimi i librave dhe regjistrave kryhet të paktën çdo vit nga Auditori i Jashtëm.

17.Të sigurojë se sistemet dhe procedurat adekuate janë vendosur për të garantuar se ndërmarrja i respekton të gjitha ligjet në zbatim gjatë kyerjes së detyrave.

18.Të identifikojë, me kërkesë të KE-së, shenjat adekuate, në mënyrë që të matet rregullisht performance e ndërmarrjes publike locale.

19.Të sigurojë se veprimtaria e ndërmarrjes nuk devijon nga qëllimi që parashihet sipas Statutit pa autorizimin e qartë të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

20.Bordi i Drejtorëve mund të udhëzojë KE-në në organizimin e brendshëm të ndërmarrjes dhe alokimin e fuqisë dhe autoritetin vendim-marrës së bashku me zyrtarët e ndërmarrjes, dhe me

propozim të KE-së mund të caktojë zyrtarë të tjerë (përveç KE-së, ZKFTH-së, sekretarit të përgjithshëm dhe zyrtari për auditim të brendshëm), duke vendosur detyrat dhe rregullat e tyre në lidhje me emërimin, kompensimin, largimin apo zëvendësimin e tyre.

Neni 17 **Mbledhjet**

1. Bordi i Drejtorëve duhet të mbledhet në vendin e caktuar sipas njoftimit me shkrim për mbledhje, në zyrën e regjistruar të ndërmarrjes apo diku tjetër, kurdo që paraqitet nevoja nga ana e kryesuesit apo nga dy (2) e më shumë drejtorë.
2. Njoftimi për mbledhjen duhet të ketë rendin e ditës dhe duhet të dorëzohet me dorë apo email së paku tri ditë para mbledhjes.
3. Në rast të emergjencës, njoftimi për mbledhjen duhet të përcillet me shkrim dhe të dorëzohet me dorë apo email së paku një ditë para mbledhjes.
4. Në mbledhje, kryesuesi i Bordit të Drejtorëve, duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë statut, duhet të përcaktojë prezencën e kuorumit, të drejtojë debatin, të mbajë procesverbalin, dhe të përcaktojë dhe deklarojë rezultatet e votimit.
5. Sekretari i përgjithshëm do t'i asistojë kryesuesit, përveç nëse çështja e konfidencialitetit kërkon që drejtori të veprojë si sekretar i mbledhjes.
6. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve janë të rregullta dhe valide, me prezencën e shumicës së drejtorëve dhe votimin e shumicës së drejtorëve pjesëmarrës në mbledhje.
7. Drejtorët të cilët mund të abstenojnë nga votimi dhe drejtorët të cilët kanë paraqitur konflikt interesash nuk do të përfshihen në numrim. Në rast barazimi me vota, kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të ketë votën vendimtare.
8. Kryesuesi i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përcaktojë identitetin dhe të drejtën e pjesëmarrjes së atyre që janë të pranishëm, të udhëheq mbledhjen, dhe të konstatojë dhe deklarojë rezultatet e votimit.
9. Sekretari i përgjithshëm i mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përceptojë ngjarjet në mënyrë adekuate gjatë mbledhjes.
10. Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë për pikat e rendit të ditës, e gjithashtu edhe të lexojnë, të pranojnë apo të dërgojnë dokumentet që ndërlidhen aty (nëse ka).
11. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga shumica e drejtorëve në zyrë, do të ketë të njëjtën fuqi dhe efekt sikurse vendimi që ka kauar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, që është thirrur dhe mbajtur. Çfarëdo vendimi i tillë mund të përbëhet prej disa dokumenteve që kanë formë dhe përmbajtje identike, secili i nënshkruar nga një apo më shumë drejtor.

Neni 18 **Zyrtarët e Ndërmarrjes**

1. Zyrtarët e ndërmarrjes do të jenë: Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtari Kryesor Financiar, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm, Sekretari dhe zyrtarët e tjerë të caktuar nga Bordi i Drejtorëve.

2.Kriteret për përzgjedhjen e Zyrtarëve të Ndërmarrjes do të përcaktohen duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Neni 19

Kryeshefi Ekzekutiv

1.Kryeshefi Ekzekutiv (KE) i Ndërmarrjes do të ketë autoritet për të lidhur kontratë, në pajtueshmëri me ligjin, statutin dhe aktet e tjera nënligjore, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve.

2.Biznesi, detyrat dhe organizimi i ndërmarrjes duhet të kryhet sipas direktivave, mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë së KE, në pajtueshmëri me statutin dhe aktet ligjore të ndërmarrjes dhe vendimeve të Bordit të Drejtorëve. Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e ndërmarrjes të cilat nuk janë përgjegjësi të Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm, do të vendosen nga apo sipas direktivave dhe përgjegjësi të KE-së.

3.KE do të ketë autoritet të punësojë apo të largoj nga puna stafin e ndërmarrjes, përveç atyre që janë në kompetence ekskluzive të Bordit të Drejtorëve, për të cilët ka të drejtën e propozimit për punësim apo largim. Të drejtën e punësimit apo largimit të stafit KE mund ta delegoj edhe tek zyrtarët e tjerë përfshirë edhe :

- 3.1.Zyrtari Kryesor Financiar
- 3.2.Sekretarit edhe
- 3.3.Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm.

4.KE gjithashtu duhet të:

- 4.1.Këshillon dhe asiston Bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë së ndërmarrjes si dhe planet strategjike afatgjate.
- 4.2.Dorëzon, sipas përgjegjësi të tij Bordit të Drejtorëve, drafte të dokumenteve që parashikohen sipas ligjit për ndërmarrje publike.
- 4.3.T'i ofrojë kurdo që është e nevojshme, dhe së paku një herë në tre muaj, Bordit të Drejtorëve raporte për transaksionet kryesore të ndërmarrja nga ndërmarrja dhe për vendimet kryesore të ndërmarrja nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe të punëve të Ndërmarrjes.
- 4.4.T'i dorëzoj nën përgjegjësin e tij/saj, Bordit të Drejtorëve dokumente, letra dhe informacione në lidhje me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij/saj.

5.T'i propozojë Bordit të Drejtorëve kriteret adekuate për matjen e performancës së ndërmarrjes si dhe t'i ofroj bordit rregullisht, por më së paku çdo tre muaj raportet e matjes së performancës së ndërmarrjes kundrejt kriterëve të tilla:

- 5.1.Të themeloj dhe rishikoj hierarkin dhe strukturën organizative të ndërmarrjes.
- 5.2.T'i ofroj Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohej.
- 5.3.T'i ofroj Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që

- mund të i kërkohet nga ky i fundit, si dhe
- 5.4. Të marrë pjesë në të gjitha Mbledhjet e Përgjithshme.

Neni 20

Zyrtari Kryesor Financiar

1. Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i Ndërmarrjes do të menaxhojë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KE, çështjet financiare të ndërmarrjes, varësisht prej kufizimeve të vëna nga Bordi i Drejtorëve. ZKF do të ketë autoritetin e propozimit për lidhjen e të gjitha kontratave financiare për ndërmarrjen dhe do të jetë përgjegjës që:

- 1.1. Të mbajë llogaritë e ndërmarrjes të përditësuara dhe të sakta.
- 1.2. Të themelojë dhe udhëheq të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasurit themelore, të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet special, të rishikojë shpenzimet e të punësuarëve për të siguruar pajtushmerinë me politikat e ndërmarrjes dhe buxhetin para pagesës së tyre.
- 1.3. Të përgadisë të dhënat e ndërmarrjes për auditim në fund të vitit.
- 1.4. Të koordinojë funksionet e tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe paisjeve si dhe të bëjë blerje me KE dhe njësinë e prokurorit të ndërmarrjes.
- 1.5. Menaxhoj thesarin e ndërmarrjes.
- 1.6. Të hartoj dhe propozoj buxhetet dhe
- 1.7. Çfarëdo tjetër detyre e përcaktuar nga ana e KE.

Neni 21

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm

1. Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komisionit të Auditimit dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm të Ndërmarrjes do të jetë përgjegjës për:

- 1.1. Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit.
- 1.2. Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe
- 1.3. Përbush çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e Komisionit të Auditimit.

Neni 22

Sekretari

1. Sekretari i Ndërmarrjes vepron si më poshtë:

- 1.1. Mirëmban regjistrin e të dhënave të ndërmarrjes.
- 1.2. Vepron si agjentë i ndërmarrjes për pranimin e njoftimeve.
- 1.3. Kryen të gjitha arkivimet, publikimet për autoritetet përkatëse siç kërkohet me ligj ose sipas këtij Statuti.
- 1.4. Mbikqyrë mirmbajtjen e duhur dhe përditësimin e rreullt të web-faqes të ndërmarrjes.

- 1.5.Koordinon me KE përgaditjen e dokumenteve për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
- 1.6.Menaxhon dokumentet, kontratat e punëtorëve, përshkrimin e vendeve të punës dhe përfaqëson Ndërmarrjen në kontestet gjyqësore dhe të tjera.
- 2.Sekretari do të mbaj procesverbalin e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre, dhe do t'i shënoj ato në librin e portokollit.

Neni 23 **Detyrat e besuara**

1.Çdo Drejtor i Bordit dhe Zyrtar të Ndërmarrjes publike do të kenë detyra të lëna në mirëbesim për ndërmarrjen, në përputhje me ligjin. Këto detyra në mirëbesim gjithmonë do përfshijnë detyrat që të:

- 1.1.Veprojnë në besim të mire ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe për përfitime objektive të ndërmarrjes, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.
- 1.2.Të ushtroj fuqinë që iu është dhënë atyre ekskluzivisht në përputhje me interes më të mira kolektive.
- 1.3.Të ketë konsiderate adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tilla, duke pasur parasysh ndërlíkueshmërinë e tyre.
- 1.4.Të shmang dhe shpalos konfliktet e tanishme dhe potenciale në mes të interesave të tyre personale (direkte apo indirekte) dhe të interesave të Ndërmarrjes.
- 1.5.Të ushtrojë kujdes të arsyeshëm, zell dhe aftësi gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre.
- 1.6.Të trajtoj si konfidenciale të gjitha informatat të pranuar me arsye nga zyra e tyre ose gjatë zbatimit të detyrave të tyre.

Neni 24 **Veprimet e Bordit të Drejtorëve pa mbajtjen e mbledhjes**

1.Përveç nëse me statut ose rregullore të ndërmarrjes kërkohet që një aktivitet i Bordit të Drejtorëve të ndërmerret ekskluzivisht në mbledhje të bordit, të gjitha aktivitetet të cilat mund të ndërmerren në mbledhjet e bordit, mund të ndërmerren edhe pa mbajtjen e mbledhjes nëse me pëlqim me shkrim, që përmban edhe natyrën e aktivitetit përkatës, nënshkruhet nga të gjithë drejtorët me të drejtë vote për atë çështje.

2.Të gjitha këto pëlqime duhet të përmbahen në një ose më shumë miratime me shkrim, të cilat duhet të paraqesin aktivitetin e ndërmarr si dhe të kenë nënshkrimin e një ose më shumë drejtorëve.

3.Të gjitha këto pëlqime duhet të vendosen në procesverbalin nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes. Pëlqimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të gjithë drejtorët, përveç nëse është caktuar një date tjetër e hyrjes në fuqi.

Neni 25

Komisionet e Bordit

1. Bordi i Drejtorëve, me rregulloren e tij të brendshme, përcakton kur mund të miratojnë themelimin e një ose më shumë komisioneve (komisioni për auditim ose për shqyrtimin e kompensimeve), që do të shqyrtojë, hulumtojë, rekomandojë ose të marrë masa të tjera jo obligative e që janë në kuadër të kompetencës së bordit.

2. Komisionet, mund të përfshijnë edhe anëtarët e bordit të drejtorëve edhe punëtorët e ndërmarrjes si dhe persona jashtë kompanisë, sipas përcakimit në rregullore.

3. Miratimi i rregulloreve për marrjen e vendimeve të bordit kërkojnë një numër më të madh të presences, shumica e anëtarëve të komisionit e përbëjnë kourumin dhe shumica e kourumit është e nevojshme për çdo rekomandim ose veprim tjetër të komisionit. Të gjitha vendimet dhe veprimet e tjera të komisionit i nënshtrohen rishikimit, ndryshimit dhe miratimit me jo më pak se 2/3 e anëtarëve të bordit.

Neni 26

Raporti i Bordit të Drejtorëve

Pas çdo takimi të Bordit të Drejtorëve, duhet të hartoj një raport të shkurtë në një gjuhë të qartë, duke vënë në pah një përmendje të vendimeve më të rëndësishme dhe rezolutave të arritura në mbledhje, duke i fshehur vetëm ato informata në lidhje me të cilat nevojitet konfidencialiteti i arsyeshëm. Informata të tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për të ruajtur konfidencialitetin.

Neni 27

Konflikti i Interesit

1. Drejtorët dhe zyrtarët e një NP nuk mund të hyjnë në marrëveshje me atë të NP, përveç nëse ajo marrëveshje së pari miratohet nga aksionarët. Ky kufizim nuk aplikohet për kontratat e punësimit të zyrtarëve, për të cilat kërkohet vetëm miratimi i Bordit të Drejtorëve.

2. Drejtorët dhe zyrtarët e NP-së do të zbulojnë plotësisht me shkrim para Bordit të Drejtorëve të NP-së, çfarëdo interesa personale të çfarëdo natyre të cilat mund t'i kenë në lidhje me një aksion ose vendim afarist i cili do të merret nga NP në veçanti ata duhet që gjithmonë të zbulojnë interes financiar të cilat mund ti kenë më konkurruesit afarist, kreditorët, furnizuesit e mallrave ose shërbimeve ose konsumatorët afarist të NP-së.

3.Zbulimi i konfliktit të interesave i lartë cekur në paragrafin 2 të nenit 27, duhet të bëhet nga çdo individ në kohën kur çështja përkatëse shfaqet ose në kohën kur individ i merr pozitën përkatëse në NP.

Neni 28

Transaksionet me palët e ndërlidhura

1.Komisioni i Auditimit, rregullisht së paku çdo tre muaj do të lëshoj një raport të shkurtë dhe me një gjuhë të qartë, duke nxjerrë në pah transaksionet më të rëndësishme me palët e ndërlidhura të cilat nuk i ka miratuar, duke dhënë arsyet për mos-miratimin e tyre, dhe të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura që i ka miratuar duke paraqitur vlerën e transaksioneve.

2.Vlera e bilanceve të paguara, duke përfshirë kushtet, konditat dhe garancitë, provizionet për borxhet e dyshimta lidhur me vlerën e bilanceve të papaguara, dhe shpenzimet e paparanuara gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija (të papaguara) apo të dyshimta të caktuara nga palët përkatëse si dhe deklaratat se kjo e fundit ka qenë e arsyeshme dhe e drejtë për shoqërinë.

3.Një pjesë e informative të tilla mund të mbahet nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të ndërmarrjes, dhe informatat e tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për konfidencialitet. Në asnjë rrethanë informacioni nuk mund të mbahet për shkak të interesave të pales përkatëse të ndërlidhur.

4.Faqjen Elektronike (web-faqen), Ndërmarrja do ta krijojë dhe në mënyrë të rregullt do të freskohet, nën përgjegjësinë e KE-së, në web-faqe do të parqiten këto informacione si më poshtë:

- 4.1.Dokumentet zyrtare që parashihen dhe raportin për dokumentet e tilla nga Komisioni i Auditimit.
- 4.2.Raporti nga auditori i jashtëm për pasqyrat financiare që parashihen me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.
- 4.3.Listën e kontratave më të rëndësishme të prokurimit që janë lidhur gjatë vitit aktual financiar, që tregojnë natyrën e tyre, çmimin dhe palët tjera, paparagjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet fundit. Atëherë kur ndërmarrja të veproj në një treg garues, ajo mund të fshijë të dhënat e ndjeshme komerciale në lidhje me çmimet nga shpalosjet e tilla.
- 4.4.Listën e të gjitha kontratave të prokurimit të lidhura gjatë vitit aktual financiar pa ndjekur procedurat e tenderimit, duke treguar për natyrën e tyre, çmimin, palët e tjera (pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet këtij të fundit) dhe arsyen pse procedurat e tenderimit nuk janë përcjellë.
- 4.5.Çfarëdo padie në gjykatë apo rastet në pritje në lidhje me vlefshmërinë e çfarëdo zgjedhjeje të drejtorit, shkelje të detyrave të mirëbesimit të drejtorëve apo zyrtarëve apo vlefshmëria e çfarëdo vendimi të miratuar nga ana e Bordit të Drejtorëve.
- 4.6.Të gjitha informatat dhe dokumentet e tilla do të shperndahen në paragrafe të ndarë dhe në mënyrë të lehtë për t'i qasur, me lidhje tek dokumentet tjera kurdo që të jetë e nevojshme, dhe do të pëfshihet në një paragraf të vetëm të web-faqës e cila i dedikohet shpjosjeve publike për çështjet e ndërmarrjes, dhe do të vendoset në një mënyrë të thjeshtë dhe që mund të lexohet lehtë, e cila duhet të ketë një format që mund të printohet lehtë.

Neni 29

Raportimet Financiare

Viti financiar i ndërmarrjes do të jetë i njëjtë me vitin kalendarik.

Neni 30

Detyrime për mos konkurrencë

Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarëte Ndërmarrjes, nuk mund të jenë të përfshirë në konkurrencë tregtare kundër ndërmarrjes. Kjo konkurrencë përfshinë, por nuk kufizohet vetëm në punësimin, për të qenë ortak i përgjithshëm, menaxher, drejtor ose anëtar kontrollues ose aksionar në ndonjë shoqëri tjetër tregtare që ushtron aktivitete tregtare konkurruese.

Neni 31

Ndryshimi i Statutit

Ndërmarrja mund të bëjë ndryshimin e statutit të saj në çdo kohë, sipas Ligjit Nr. 06/L-016 Për Shoqërit Tregtare.

Neni 32

Likuidimi i ndërmarrjes

Likuidimi i Ndërmarrjes bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 33

Dispozitat përfundimtare

Në rast të mos rregullimit eventual të ndonjë çështje me këtë Statut, zbatohet dispozita ligjore të Ligjit Nr.03/L-087 për ndërmarrjet Publike si dhe Ligjit Nr. 06/L-016 Për Shoqërit Tregtare.

Neni 34

Hyrja në fuqi

Statuti për Nërmarrjen publike Stacioni i Autobusëve SH.A. në Glllogoc, hynë në fuqi 8 ditë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e portokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushteit Lokal.



Kryetari i Komunës:
Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

01 Nr - 020 - 13792 dt. 13/03 2020

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gaz.Zyrt.e Republikës së Kosovës"), nenit 34 të Statutit të Komunës së Gllogocit, nenit 24 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 4 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, të datës 28 tetor 2010, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2020 , të aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen, në parcelën 743/1, në zonën kadastrale

Drenas

Neni 1

Më këtë Propozim Vendim formohet Komisioni për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen, në parcelën 743/1, në zonën kadastrale në Drenas në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, dhe dy (2) anëtar nga Kuvendi i Komunës:

1. _____ -anëtar nga ekzekutivi
2. _____ -anëtar nga ekzekutivi
3. _____ -anëtar nga ekzekutivi
4. _____ - anëtar nga kuvendi
5. _____ -anëtar nga kuvendi

Neni 2

Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e të gjitha banesave private që ndodhen në pronën komunale në parcelën 743/1, e të cilat në bazë të m² ka mundësi këmbimi me pronën komunale, në të njëjtën kohë të vlerësohen banesat komunale që duhet të këmben me banesat private.

Neni 3

Komisioni po ashtu ka për detyrë që të vlerësoj që cilat banesa private që ndodhen në pronën komunale në parcelën 743/1, në bazë të m² nuk mund të këmben, e që do të duhet të vazhdohet sipas procedurave të shpronësimit.

Neni 4

Ky këmbim, respektivisht shpronësim, ka për qëllimin lirim të pronës komunale në parcelën 743/1, në zonën kadastrale në Drenas, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshme, duke siguruar edhe qëllimin për përmbushjen e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Neni 5

Pas aprovimit të këtij propozim vendimi, komisioni brenda një afati të arsyeshëm duhet të vie me propozime konkrete pranë kuvendit të komunës së Drenasit.

Neni 6

Ky propozim vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

 Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh Planin Zhvillimor Komunal, Hartat Zonale dhe Planifikimin Urban në Komunën e Drenasit, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm, në zonën kadastrale në Drenas, në parcelën 743/1, do të behët këmbimi, respektivisht shpronësimi i banesave pronë private, të cilat ndodhen në pronën e komunës së Drenasit, duke siguruar edhe qëllimin e përmbushjes së interesit publik dhe zhvillimin ekonomik lokal.

Parcela 743/1, në zonën kadastrale në Drenas, në bazë të Planit Zhvillimor Komunal është zonë e planifikuar për ndërtim të lartë.

Andaj, qëllimi i këtij komisioni është që të bëjë vlerësimin e të gjitha banesave private të cilat ndodhen në pronën komunale, e të cilat mund të këmbehen me banesat pronë komunale, në të njëjtën kohë të ipen rekomandimet për banesat private të cilat në bazë të m² nuk mund të këmbehen.

Duke pasuar parasysh këto që u thanë me lartë kërkoj nga ana juaj që të aprovonë këtë propozim vendim me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm në atë zonë.

Me respekt!